



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2020-10

Vendosën: Gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 qershor 2020

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Dosja e vendimeve organizative të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2020

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi zgjedhjen e kryegjykatësit

1. Në bazë të rregullës 7(1) e Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e punës"), gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese zgjedhin me shumicë absolute dhe për një mandat njëvjeçar një kryegjykatës i cili përmbush përgjegjësitë e përcaktuara pas caktimit në detyrë nga Kryetari i Dhomave të Specializuara.

2. Më 1 qershor 2020, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese u mbledhën nëpërmjet mjeteve të komunikimit për të zgjedhur kryegjykatësin e Dhomës së Specializuar në bazë të rregullës 7 të Rregullores së Punës.

Gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

Zgjedhin gjykatësin Vidar Stensland si kryegjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

/nënshkrimi/

Vidar Stensland

Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e hënë, 1 qershor 2020

Në Hagë, Holandë